# DËSHMI ARKIVI

**A-401709**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Preferohet antikiteti, në Bylis nis qendra multifunksionale me muze dhe shërbime të reja për turistët |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/06/preferohet-antikiteti-ne-bylis-nis-qendra-multifunksionale-me-muze-dhe-sherbime-te-reja-per-turistet/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 10:19:01 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 6 shtator 2026, 13:17:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 6 shtator 2026, 13:16:00 UTC → 6 shtator 2026, 13:18:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `342007744236a4a312b1dd797684d35361c208883b80a1107be22cfc3524ef42` |
| TEKSTI | `86e20da880a353a051093c37515529ee8cd7bd4903922da450561e1345e3f60a` |
| PAMJA | `6fadfada1275b18c414e0f5203eab95ee06cec457f6e47d8e365f0dd8e0e6494` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0b1415dc314f5ce93385a3342b20a76f4c1e6df59dc9b04c1fba066d9b4beca2` |
| E MËPARSHMJA | `02fc4bab1c46438416eec80aac26621f86a583b92450f08c1af0e6ecbabdecd6` |
| RRËNJA MERKLE | `b153b854c154dd4d6c3613e7c633ddb6afc042e1cebe995d4321c2de8150c895` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0b1415dc314f5ce93385a3342b20a76f4c1e6df59dc9b04c1fba066d9b4beca2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KULTURË TË FUNDIT

# Preferohet antikiteti, në Bylis nis qendra multifunksionale me muze dhe shërbime të reja për turistët

06/09/2026 15:17



**Edhe pse temperaturat e larta të këtyre ditëve kanë orientuar pjesën më të madhe të turistëve drejt plazheve, Apolonia dhe Bylisi vijojnë të mbeten dy prej destinacioneve më të rëndësishme të turizmit kulturor në jug të Shqipërisë.**

Çdo ditë, vizitorë vendas dhe të huaj ndalojnë në këto qytete antike për t'u njohur nga afër me historinë, monumentet dhe gjurmët e qytetërimeve të lashta. Në Parkun Arkeologjik të Apolonisë, interesi i turistëve vijon të jetë i lartë.

"Është hera e parë që vijmë në Shqipëri. Kemi shkuar në Tiranë, më pas në mal dhe tani jemi kthyer në jug për të vizituar Apoloninë. Është një vend shumë i bukur dhe me shumë histori. Në Shqipëri na pëlqen ushqimi dhe shpresojmë të kthehemi përsëri", shprehet turisti.

"Më pëlqen shumë Shqipëria, njerëzit janë shumë mikpritës, ushqimi shumë i mirë, ka shumë vende historike interesante. I sugjeroj të gjithëve të vijnë dhe ta vizitojnë", thotë turisti.

Sipas arkeologut Arjan Dimo, krahasuar me një vit më parë është shënuar një rritje e vazhdueshme e numrit të vizitorëve.

Historia, monumentet dhe trashëgimia kulturore janë ndër arsyet kryesore që turistët zgjedhin të përfshijnë Apoloninë në itineraret e tyre. Por një tjetër pikë e rëndësishme e turizmit kulturor është edhe Parku Arkeologjik i Bylisit. Aty ka nisur ndërtimi i një qendre multifunksionale, e cila do të përfshijë muzeun dhe shërbime të tjera për vizitorët, duke pritet të rrisë ndjeshëm interesin dhe numrin e turistëve.

Gjatë muajve të verës, turizmi detar dhe ai malor mbeten më të preferuarit për shkak të temperaturave të larta. Por Apolonia dhe Bylisi vijojnë të tërheqin vizitorë edhe në këtë periudhë, duke dëshmuar se turizmi kulturor po fiton gjithnjë e më shumë hapësirë. Dy qytetet antike mbeten sot pika të rëndësishme referimi për trashëgiminë kulturore dhe historinë e Shqipërisë, duke u ofruar turistëve një udhëtim unik mes monumenteve dhe gjurmëve të antikitetit.

**Top Channel**


## Kulturë »









## Kryesore





Konflikti mes biznesmemëve në Vlorë, gjykata jep masat për të arrestuarit, "detyrim paraqitje" për Luan Muçën, vetëm "arrest në shtëpi" për truprojën e Bedinajt që qëlloi me armë
14:59

Top Channel hap sezonin e ri/ Sara Hoxha: Pas 25 vitesh histori, ndryshojmë për të mbetur zgjedhja e parë e shqiptarëve
19:43

"Ka përdorur mediat për të baltosur ata që do të merrte nën akuzë", Rama për SPAK: Një nga gjërat më të këqija që ka bërë
10:37

Zjarret në vend/ 32 vatra zjarri në 24 orë, 11 ende aktive, ushtria dhe zjarrfikësit në aksion në zonat problematike
11:05

Drejt Juventus-Milan, Gianluigi Buffon rrëfen: Më bën ende të mendoj Manchesterin. Woltemade si Ibrahimovic, Spalletti një magjistar
12:35

## Më të lexuarat

Megaoperacion në Sarandë, arrestohen "kokat" e grupeve që shpërndanin drogë

Mitsotakis shpall paketën e re ekonomike për Greqinë. Rritje pagash, 400 euro për pensionistët dhe lehtësime fiskale

Përshkallëzohet konflikti në Ngushticën e Hormuzit, Irani hakmerret duke sulmuar disa anije pas operacionit të SHBA

Droni me eksplozivë në aeroportin e Leipzigut, Lavrov kërcënon: Është fillimi i një lufte të vërtetë

Video/ Broja përplaset me tifozin pas humbjes, sulmuesi i Kombëtares: Kam qenë jashtë për një vit

Përfundojnë rregullat e fleksibilitetit për kontrollet e hyrje-daljeve në BE, priten radhë të reja në kufi, linjat ajrore bëjnë paralajmërimin

"Askush nuk do ta fitojë këtë luftë", këshilltari i Zelenskyt paralajmëron shkatërrim: Nëse lufta me Rusinë vazhdon...

"Nuk jam shitësi i Shqipërisë", Rama paralajmëron nisjen e podkastit "Flasim": Nuk kam ndërmend të zgjedh pasardhës, pushteti...

Mbi 220 mijë turistë në Kala, vetëm 18 mijë hyjnë në Muzeun e Armëve, bileta shtesë ngre pikëpyetje
06/09 12:17

Rikthimi i madh i kinematografisë/ Festivali Kombëtar i Filmit Shqiptar edicioni 14, bashkon brezat pas 14 vitesh mungese
06/09 11:37

Shën Tereza, 10 vjet shenjtore/ Ekspozohen në Tiranë dorëshkrimet shqip që dëshmojnë lidhjen e saj me atdheun
05/09 15:32

Si u bë Gjermania nga një vend emigrimi në një vend imigrimi

“Ka përdorur mediat për të baltosur ata që do të merrte nën akuzë”, Rama për SPAK: Një nga gjërat më të këqija që ka bërë



Nderohen ikonat e kinemasë, Festivali i Filmit Shqiptar nderon 16 figura, artistët kërkojnë më shumë mbështetje
04/09 15:27



“Aktrimi ka qenë ëndrra ime, ia dedikoj atyre që më mësuan”/ Reshat Arbana në lot: Nuk dal dot në pazar dhe kafe se të gjithë duan të rrinë me mua
04/09 12:44



“Do doja që Dhimitrin ta kisha në krah”/ Festivali i 14-të i Filmit, përlotet Roza Anagnosti: Ky çmim është dhe për të
04/09 12:22

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Fieri nën pushtetin e flakëve! Dy vatra zjarri në pyllin e Dërmenasit



Top News – Moska gati të sulmojë Gjermaninë. Lavrov i prerë – Ky është fillimi i vërtetë i luftës



Top Channel/ Preferohet antikiteti/Në Bylis nis qendra multifunksionale me muze dhe shërbime të reja



Top News – Kosova rrezikon 166 mln euro. Fondet e BE për planin e rritjes do të ‘digjen’



Top Channel/ Helmimi në Fushë Arrëz/ Banorët: Asnjë përgjigje për ujin, s’dimë nëse duhet përdorur



Top Channel/ A i mbron dot Anglia ishujt?/ Ishujt Falkland, Argjentina i ka shpresat tek Trump



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.